



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshor

Kryesia e Kuvendit

P-036

Prishtinë, më 5 tetor 2015, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 TETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Driton Lajçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentes: Amir Haradinaj,

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Lejla Selimi,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati,

Nga KDI-ja: Driton Selmanaj.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Çështjet vijuese

* * *

Më pas, kryetari i propozoi Kryesisë së Kuvendit që seanca plenare t'i vazhdojë punimet më 8 tetor 2015.

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, vendosi që seanca plenare t'i vazhdojë punimet të enjten, më 8 tetor 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes Bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: "KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës",
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë termike,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 15:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale